



REPUBLICA E KOSOVES	REPUBLICA KOSOVA	UNIVERSITETI
MINISTRU, E ARSIMIT,	SHKENCES	"HAXHI ZEKA"
DHE TEKNOLOGJIS		PEJE
REKTORATI		
Nr. / Br. / No.	252	Nr. ifaq/ Dr. str / No. pg 1
Date / Data / Dato	07.02.2023	Pejë / Peć

UNIVERSITETI - UNIVERSITY - UNIVERZITET  
"HAXHI ZEKA"

Këshilli Drejtues

Datë: 06.02.2023

Në bazë të nenit 17 dhe nenit 23 të Statutit Nr. 04-V-622 të Universitetit "Haxhi Zeka" Pejë, Këshilli Drejtues në mbledhjen e mbajtur me 03.02.2023, morri këtë:

**V E N D I M**

- I. MIRATOHET Kodi për Etikë dhe Integritet në kërkime shkencore.
- II. Këtij vendimi i bashkangjitet Kodi për Etikë dhe Integritet në kërkime shkencore.
- III. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.



**Vendimi t'i dërgohet:** Kryesueses së KD-së, Anëtarëve të KD-së, Rektorit, U.d. Sekretares së Përgjithshme, Kryesuesit për Teknologji të Informacionit, Arkivës së UHZ-së.



UNIVERSITETI - UNIVERSITY - UNIVERZITET  
"HAXHI ZEKA"

## KODI PËR ETIKË DHE INTEGRITET NË KËRKIME SHKENCORE

### Neni 1 Objekti

Kodi Etik në Kërkime Shkencore në UHZ përban parimet dhe normat themelore të sjelljes së personelit akademik ose kërkues shkencor, në përputhje me Statutin e UHZ-së dhe Kodin Evropian të Sjelljes për Integritet në Kërkimin Shkencore.

### Neni 2 Qëllimi

1. Qëllimi i Kodit Etik në Kërkime Shkencore (KEKSH) në UHZ është të krijojë një kornizë vetëregulluese për kryerjen e kërkimeve në përputhje me parimet dhe përgjegjësitë për etikën dhe integritetin e kërkimeve, të cilat kryhen nga stafi akademik, administrative, kërkues shkencorë dhe student, e UHZ-së.
2. Kodi Etik në Kërkime Shkencore synon të ruajë, të garantojë dhe të mbrojë transparencën dhe integritetin akademik, profesional, institucional dhe moral të veprimtarisë akademike e kërkimore-shkencore edhe është në përputhje me standardet ndërkombëtare bashkëkohore të veprimtarisë akademike dhe të kërkimit shkencor.

### Neni 3 Fusha e Zbatimit

1. Kodi Etik në Kërkime Shkencore zbatohet për:
  - a. Hulumtuesit (përfshirë personelin akademik, asistentët hulumtues, bashkëpunëtorët hulumtues) apo personel të punësuar nga UHZ, qoftë të përfshirë në procesin e kërkimit brenda UHZ-së, ose në një institucion tjetër;
  - b. Studentët që ndërmarrin kërkime dhe mbikëqyrësit e tyre;
  - c. Çdo person të angazhuar në UHZ i cili është i përfshirë në kërkime brenda, ose në emër të UHZ-së. Termi "hulumtues" është përdorur për lehtësi në këtë Kod Sjelljeje dhe i referohet njërsë ose të gjitha kategorive të mësipërme, sipas rastit.

#### **Neni 4**

#### **Liria akademike dhe e kërkimit shkencore**

Veprimtaria akademike dhe kërkimi shkencor ngrihen mbi bazën e lirisë akademike, e cila garantohet nëpërmjet së drejtës për të përcaktuar çështjet akademike dhe të kërkimit, për të zhvilluar teori, për të grumbulluar të dhëna empirike dhe për të përdorur metoda të përshtatshme. Veprimtaria akademike dhe kërkimi shkencor zhvillohen në mënyrë të pavarur nga çdo ndikim negativ mbi kërkimin dhe rezultatet e tij si edhe nga ndikimet ideologjike, politike, ekonomike, teknologjike, ose nga ndryshimet në mjedisin e kërkimit.

#### **Neni 5**

#### **Përgjegjësia e komunitetit akademik e shkencor**

Komuniteti akademik dhe shkencor duhet të zhvillojë dhe të zbatojë parimet, normat, standardet dhe kriteret e etikes në kërkime shkencore në institucionet dhe disiplinat shkencore përkatëse.

#### **Neni 6**

#### **Parimet e kërkimit shkencor**

Parimet themelore të integritetit në kërkime shkencore orientojnë kërkuesit në punën dhe angazhimin e tyre ndaj sfidave praktike, etike dhe intelektuale që shoqërojnë ose burojnë nga kërkimi shkencor. Këto parime janë:

- a. garancia për cilësinë e kërkimit;
- b. ndershmëri në zhvillimin dhe në komunikimin e rezultateve me transparencë, në mënyrë të drejtë dhe paanshmëri;
- c. respekti për kolegët;
- d. kujdesi për trashëgiminë kulturore dhe mjedisin;
- e. përgjegjësia sociale për kërkimin.

#### **Neni 7**

#### **Praktikat e mira në kërkimin shkencor**

Kërkimi shkencor udhëhiqet nga modeli i praktikave më të mira, të cilat përfshijnë aspektet e mëposhtme:

- Mjedisin e kërkimit;
- Trajnimin për kërkime shkencore;
- Udhëheqjen e kërkimit dhe të studimit;
- Procedurat e kërkimeve shkencore;
- Mbrojtjen e kërkimeve;
- Punën në grup dhe bashkëpunim;
- Botimin e rezultateve të kërkimit;
- Vlerësimin e kërkimit

## **Neni 8**

### **Mjedisi i kërkimit**

1. UHZ udhëheq me politika dhe zbaton procedura të mbështetura në praktikat më të mira të kërkimit shkencor.
2. UHZ mbështete me infrastrukturën e nevojshme përdorimin dhe mbrojtjen e të dhënavës dhe materialeve të kërkimit në të gjitha format e tyre, të lidhura me riprodhimin, vazhdimësinë e kërkimit dhe përgjegjësinë sociale të rezultateve të kërkimit: statistikat, informacionet, procesin, dokumentet, etj
3. UHZ inkurajon promovimin profesional dhe institucional të kërkuesve, nëpërmjet shpërblimit, meritokracisë dhe transparencës.

## **Neni 9**

### **Trajnimi, mbikëqyrja dhe udhëheqja e kërkimit shkencor**

1. UHZ krijon kushtet dhe ofron garanci për përditësimin teorik dhe trajnimin metodologjik të kërkuesve.
2. UHZ mbështete trajnimin e kërkuesve për zbatimin e normave të etikës dhe standardeve të integritetit, të pasqyruara në rregulloret përkatëse për kërkim shkencor .
3. Kërkuesit më të vjetër apo ata me përvojë në fushën e kërkimeve, mbështesin dhe nxisin zhvillimin e aftësive profesionale të kërkuesve më të rinj.

## **Neni 10**

### **Bashkautorësia**

1. Të gjithë bashkëpunëtorët në hulumtimet e përbashkëta njohin kontributin e njëri-tjetrit si bashkautorë në të gjitha fazat e kërkimit sipas Ligji për të drejtat e autorit dhe të drejtat e përafërtë. Varësisht nga revista ku publikohet njohja e kontributit të bashkautorëve në fazën e konceptimit, mbledhjes së të dhënavës, analizës dhe interpretimit të rezultateve.
2. Kontributet e bashkëpunëtorëve në kërkime dhe të gjithë të tjera që ndihmuant drejtpërdrejt ose tërthorazi e mbështetën kërkimin duhet të njihen siç duhet. Mosnjohja e kontributeve të të tjera konsiderohet si sjellje joprofesionale jo-etike.

## **Neni 11**

### **Botimi i rezultateve të kërkimit**

UHZ do të inkurajojë dhe mbështesë studiuesit që të publikojnë gjetjet e tyre kërkimore. Mund të ketë situata kur një kërkesë për shtyrje të publikimit bëhet me legjitimitet (si p.sh. kur bashkëpunohet me një partner industrial, i cili mund të dëshirojë që botimi të shtyhet derisa të sigurohet mbrojtja e duhur e çdo prone intelektuale). Vonesa e kërkuar për publikim nuk do të jetë më e gjatë se sa është e nevojshme.

## **Neni 12**

### **Kriteret e përfshirjes në kërkimin shkencor**

Kriteret e përfshirjes në kërkimin shkencor përfshijnë kërkues shkencorë të cilët zotërojnë njohuritë, metodologjitetë dhe praktikat etike të lidhura me fushën e tyre të kërkimit. Shmangia nga kjo përgjegjësi dëmon procesin e kërkimit dhe marrëdhëniet midis kërkuesve, minon besueshmërinë e kërkimit shkencor dhe shkakton shpenzime të pajustifikuara të burimeve. Kjo përbën shkelje të integritetit në kërkime shkencore dhe dënohet me masat e parashikuara në këtë kod.

## **Neni 13**

### **Sjellje dhe praktika të papranueshme në kërkimin shkencor**

**Fabrikimi** është sajimi i rezultateve dhe regjistrimi i tyre sikur të ishin të vërteta.

**Falsifikimi** është manipulimi i materialeve të kërkimit, pajisjeve apo proceseve ose ndryshimi, heqja apo shmangja e të dhënave apo rezultateve pa justifikim.

**Plagjiatura** është përdorimi i ideve dhe punës së të tjerëve pa ia njohur vlerën burimit origjinal, duke shkelur në këtë mënyrë të drejtat e autorëve dhe produktet e tyre intelektuale.

Këto tri forma shkeljesh konsiderohen në mënyrë të veçantë serioze përderisa ato prishin të dhënat e kërkimit. Ka edhe shkelje të tjera të praktikës pozitive të kërkimit që dëmon integritetin e procesit të kërkimit apo të kërkuesve. Përveç shkeljeve të drejtpërdrejta të praktikave pozitive të kërkimit parashtruar në këtë Kod të Sjelljes, shembuj të praktikave të tjera të papranueshme përfshijnë, por nuk kufizohen me:

- Manipulimi i autorësisë apo denigrimi i rolit të kërkuesve të tjerë në botime.
- Ribotimi i pjesëve thelbësore të botimeve të veta më të hershme, pa cituar origjinalin ('vetëplagjiarizëm').
- Citimi në mënyrë përzgjedhëse për të zmadhuar gjetjet e veta ose për të kënaqur redaktorët apo kolegët.
- Fshehja e rezultateve të kërkimit.
- Lejimi i financuesve / sponsorizuesve të rrezikojnë pavarësinë gjatë procesit të kërkimit ose në raportimin e rezultateve, me qëllim krijimin e konteksteve të njëanshme.
- Zgjerimi në mënyrë të panevojshme i bibliografisë së një studimi.
- Akuzimi i një studiuesi për sjellje të papranueshme apo shkelje të tjera në mënyrë keqdashëse.
- Keqrezantimi i arritjeve të kërkimit.
- Tejzmadhimi i rëndësisë dhe i zbatueshmërisë praktike të gjetjeve.
- Vonesa apo pengimi i punës së kërkuesve të tjerë.
- Keqpërdorimi i pozitës më të lartë për të inkuruar shkelje të integritetit kërkimor.
- Anashkalimi i shkeljeve të mundshme të integritetit kërkimor kryer nga të tjerë ose

mbulimi me përgjigje të papërshtatshme për sjelljet e papranueshme apo shkeljet e tjera nga institucionet.

- Themelimi apo mbështetja e revistave që minojnë kontrollin e cilësisë së kërkimit ['revista grabitqare (predatory journals)].

Në formën e tyre më serioze, praktikat e papranueshme janë të sanksionueshme, por gjithsesi duhet bërë çdo përpjekje për t'i parandaluar, për t'i dekurajuar dhe për t'i ndaluar ato nëpërmjet trajnimit, mbikëqyrjes dhe mentorimit dhe nëpërmjet zhvillimit të një mjedisi kërkimor pozitiv dhe mbështetës.

#### **Neni 14** **Këshilli i Etikës në kërkime shkencore**

1. Këshilli i Etikës për Kërkime Shkencore (KEKSH) në Universitet është organ i zgjedhur nga Senati i UHZ-së, sipas propozimit të Rektorit.
2. KEKSH përbëhet nga 7 anëtarë, nga një anëtar nga secila njësi akademike, një anëtar nga stafi administrativ dhe një student me notë mesatare mbi 9.
3. KEKSH zhvillon procedurat e verifikimit dhe të shqyrtimit të shkeljeve të raportuar dhe merr vendime mbi bazën e këtij kodi dhe sipas procedurave te parapara me rregulloren e punes se këtij këshilli.
4. KESHK përcaktojë standartet për kryerjen etike të hulumtimit brenda Universitetit.

#### **Neni 15** **Detyrat e Këshillit**

##### *1. Detyrat e Këshillit të etikës në kërkime shkencore janë:*

- 1.1. Të formulojë dhe të përcaktojë politikat, procedurat dhe dokumentet e praktikave më të mira në lidhje me kryerjen dhe publikimin e kërkimit dhe të sigurojë që këto politika të zbatohen brenda fushave të përgjegjësisë;
- 1.2. Të promovojë ndërgjegjësimin për legjisacionin përkatës dhe parimet etike që rregullojnë praktikën kërkimore;
- 1.3. Të nxisë një mjesid që inkurajon marrjen e një qasjeje të përgjegjshme dhe etike në të gjitha fushat e kryerjes së kërkimit dhe praktikave të botimit;
- 1.4. Të identifikojë nevojat arsimore midis anëtarëve të komisionit dhe studiuesve në lidhje me çështjet etike dhe të ofrojë seminare dhe trajnime për adresimin e tyre;
- 1.5. Për të rishikuar praktikat më të mira në kërkimin shkencor, për të marrë parasysh zhvillimin e politikave etike dhe për të promovuar arsimin brenda UHZ-së në çështjet e etikës dhe integritetit të kërkimit;

- 1.6. Të shqyrtojë dhe raportojë për të gjitha aplikimet e dorëzuara për shqyrtim etik duke siguruar që praktikat e kërkimit të përmbushin standardet e përgjithshme etike të vendosura brenda UHZ-së;
- 1.7. Të rishikojë funksionet, procedurat dhe rezultatet e veta për qëllime të vlerësimit të cilësisë dhe përmirësimit të cilësisë;
- 1.8. Të përcaktojë urdhrat e përhershëm lidhur me qeverisjen, kuorumin, kryesinë etj.

**Neni 16**  
**Mbledhjet e KEKSH**

1. Mbledhjet e Këshillit thirren nga Kryesuesi, apo me 2/3 e anëtarëve.
2. Propozim/vendimet merën më shumicë absolute.
3. Për mbajtjen e mbledhjeve të këshillit nevojitet kuorumi sepakun 5 anëtarë, për të vazhduar me rendin e ditës së mbledhjes.
4. KEKSH obligohet që të nxjerrë rregulloren e tij të punës në përputhje me këtë Kod.

**Neni 17**  
**Masat ndëshkuese ndëshkuese**

*1. Masat ndëshkuese për stafin që bije ndesh me këtë kodë janë:*

1.2 Masat ndëshkuese të tjera për shkeljet e parapara në nenin 17:

- ✓ Vërejtje me shkrim
  - ✓ Mos financim të kërkimeve dhe projekteve për periudhë 2 vjeçare
  - ✓ 30% e pagës për tre muaj me radhë
  - ✓ Mospjesëmarrje në projektet ndërkombëtare për periudhë 2 vjeçare
2. Shqyrtimi i shkeljes së pretenduar etike behët nga Këshilli i Etikës në Kërkime Shkencore, ndërsa shqiptimi i masave behët nga Senati i Universitetit sipas propozimit të Këshillit të Etikës në Kërkime Shkencore.
  3. Masa shqiptohen në proporcion me pasojat dhe dëmet e shkaktuara.

**Neni 18**  
**Hyrja në fuqi**

Ky Kod hyn në fuqi ditën e miratimit nga këshilli Drejtues i Universitetit “Haxhi Zeka” në Pejë.

Kryesuese e Këshillit Drejtues të UHZ-së.

Prof. Ass. Dr. Majlinda Belegu

